

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Shtërpca – Raporti komunal

Nëntor 2009

## Shtërpsa në shifra

<b>Popullsia</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>13885</b>
	Serbë	67.4%
	Shqiptarë	32.4%
	Të tjerë	0.2%
<b>Gjeografia</b>	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	248
	Numri i fshatrave	16
<b>Shkollimi</b>	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	15.29%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	24.79%
	E mesme	47.52%
	Shkollë e lartë	10.74%
	Universitet	1.65%
	Nr. i nxënësve	826
	Nr. i mësimdhënësve	73
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	1
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	8
	Nr. i çerdheve	0
	<b>Shëndetësia</b>	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		-
Nr. i mjekëve		3
<b>Papunësia</b>	Gjithsej	35.59%
	Meshkuj	35.69%
	Femra	35.29%
<b>Të punësuar</b>	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	8,470
	Të punësuar në sektorin publik komunal	320
<b>Buxheti 2009</b>	Gjithsej (Euro)	1,643,373
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	45,740
	Të hyrat tjera (Euro)	1,597,633
<b>Shpenzimet e realizuara (2008)<sup>1</sup></b>	Gjithsej (Euro)	993,085 (91%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	93,247 (94%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	899,838 (91%)
<b>Kryetarët e Komunës 2000-2009</b>	2000-2002: Bahri Hyseni (PDK) 2002-2007: Slagjan Ilic (SDP), Stanko Jakovljeviç (DSS) 2007-2009: Stanko Jakovljeviç (DSS)	

<sup>1</sup> Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

## Shkurt për Shtërpcën

Shtërpca është njëra ndër pesë komunat e Kosovës me popullsi shumicë serbe. Ka një sipërfaqe prej 248 km<sup>2</sup> dhe 13,000 banorë. Shtërpca është e njohur si komuna më e vizituar nga turistët në sezonin dimëror, për shkak se në këtë komunë ndodhet një ndër qendrat më të njohura të skiimit në Ballkan – Brezovica. 67.4% e popullsisë së kësaj komune janë serb dhe deri më tani një pjesë e madhe e tyre kanë refuzuar që të kyçen në jetën publike komunale të Republikës së Kosovës.

## Problemet aktuale

Problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët e komunës së Shtërpcës kanë të bëjnë me:

- Mungesa e transportit publik;
- Degradimi i pasurive natyrore;
- Ndotja e lumit Lepenc;
- Ndërtimet ilegale në Brezovicë;
- Mungesa e parkingjeve;

**Mungesa e transportit publik.** Deri në vitin 1999 Komuna e Shtërpcës ka pasur një linjë transporti Brezovic – Prishtinë. Por, që nga pas-lufta nuk ka asnjë linjë që lidh këtë komunë me komunat tjera, gjë që ka bërë që qytetarë e kësaj komune të ndihet më të izoluar. Megjithatë, veprojnë disa kombi-buse private të cilët, edhe pse pa ndonjë orar të caktuar, organizojnë transport deri në Komunën e Ferizajt. Përndryshe, e vetmja zgjidhje e banorëve të komunës së Shtërpcës është që të udhëtojnë me automjete private. Nevoja për transporti publik ndihet sidomos nga mësimmhënësit dhe nxënësit që udhëtojnë.

**Degradimi i pasurive natyrore.** Komuna e Shtërpcës është e njohur për pasurit natyrore, sidomos pyjet e bukura dhe malet e larta të përshtatshme për zhvillimin e turizmit. Ky potencial turistik jo vetëm që ka mbetur i pashfrytëzuar, por edhe më keq, ato edhe po keqpërdoren. Prerja e pyjeve shpesh behët prej vetë banorëve të kësaj komune. Përpos prerjes së pyjeve, një problematik shumë e madhe në këtë komunë është edhe gërryerja e maleve nga gurëthyesit dhe përpunuesit e zallit. Gërryerja e maleve ka filluar të paraqet rrezik për disa zona që janë në afërsi të banorëve, gjë që po shkakton rrëshqitjen e dheut. Në fshatin Brod, lagjet Smalaj dhe Rudaj janë të rrezikuara për shkak të rrëshqitjes së dheut.

**Ndotja e Lumit Lepenc.** Kompania e vetme e mbeturinave në Komunën e Shtërpcës udhëhiqet nga strukturat paralele serbe. Komunës së Shtërpcës i mungon një kompani e cila do të menaxhonte mbeturinat në mënyrë më efikase. Kësaj komune madje i mungon edhe deponia. Më parë mbeturinat janë dërguar në Velekinc të Gjilanit, por tani ato derdhen në lumin Lepenc Përpos mbeturinave, në lum derdhen edhe ujërat e zeza. Lumi Lepenc ka filluar të humb sasinë e peshkut për shkak të ndotjes. Komuna e Shtërpcës ka përpiluar një plan për krijimin e një liqeni artificial, por ky plan ka dështuar si pasoj e papastërtisë së lumit.

**Ndërtimet ilegale në Brezovicë.** Viteve të fundit vërehet një shtim i dukshëm i ndërtimeve, si të objekteve për banim, ashtu edhe vilave, restoranteve e hoteleve.

Këto ndërtime janë të pakontrolluara dhe pa ndonjë plan. Ndërtimet e pakontrolluar dëmtojnë turizmin. Për shkak të këtyre ndërtimeve, pamja e Brezovicës ka filluar që të degradohet si pasojë e gërryerjeve, transportimit të materialit ndërtimor dhe prerjes së pyjeve. Qytetarët ankohen se këto ndërtime po bëhen nga qytetarë me banim jashtë kësaj komune. Ata kundërshtojnë këto ndërtime nga frika se Brezovica mund të humb turistët, e turizmi është një nga të ardhurat kryesore për shumë banorë të kësaj ane.

**Mungesa e parkingjeve.** Një problem shumë shqetësues për komunën e Shtërpçës është edhe mungesa e parkingjeve. Mungesa e parkingjeve është më e evidente sidomos gjatë sezonit dimëror kur shumë turistë shkojnë në vizitë në malet e Brezovicës. Kjo vi si pasojë e rrugëve të ngushta nëpër lokalitetet urbane që shpiten deri në Brezovicë.

## Zgjedhjet lokale në Shtërpçë

Në zgjedhjet e para lokale të mbajtura në vitin 2000, serbët si shumicë në këtë komunë bojkotuan zgjedhjet. Në zgjedhjet e vitit 2000, shumicën e ulëseve në Kuvendin Komunal prej 17 anëtarësh e fitoi PDK me 9 ulëse, kurse LDK fitoi 8 ulëse. Kryetar i Shtërpçës në këtë mandat u zgjodh Bahri Hyseni nga PDK. Në zgjedhjet e vitit 2002 në zgjedhje morën pjesë edhe komuniteti serb dhe në këtë mënyrë gjashtë parti të ndryshme serbe fituan së bashku 13 ulëse kurse partitë shqiptare fituan 4 ulëse (PDK 2 dhe LDK 2). Në zgjedhjet e vitit 2007, sërish komuniteti serb bojkotoi zgjedhjet dhe në zgjedhje PDK fitoi 54.9% apo 9 ulëse, LDK 23.1% apo 4 ulëse, LDD 17.8% apo 3 ulëse dhe AAK 3.5% apo 1 ulëse. Mirëpo, për shkak të mos pjesëmarrjes në zgjedhje të komunitetit serb, PSSP Joachim Ryker me një vendim ekzekutiv anuloi rezultatit e zgjedhjeve dhe u zgjati mandatin delegatëve të KK të zgjedhur në vitin 2002 si dhe kryetar i komunës sërish u zgjodh me vendim Stanko Jakovljeviç (DSS). Tabela 1 pasqyron partitë politike që kanë arritur të përfaqësohen në Kuvendin Komunal në bazë të zgjedhjeve lokale.

Tab.1. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Shtërpçës.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	775	9	981	2	901	9
LDK	632	8	758	2	344	4
AAK	-	-	-	-	88	1
LDD	-	-	-	-	250	3
“Povratak”	-	-	642	2	-	-
SPO	-	-	469	1	-	-
KOC	-	-	397	1	-	-
SDP	-	-	998	3	-	-
PKM	-	-	581	1	-	-
DCC	-	-	810	2	-	-
SSZ	-	-	1278	3	-	-

Në dy nga tri palë zgjedhjet e gjertanishme në Komunën e Shtërpçës, numri i votuesve ka qenë shumë i ulët. Në zgjedhjet e para lokale, vetëm 1,595 votues iu kanë përgjigjur ftesës për votime. Qytetarët serb refuzuan pjesëmarrjen në votime. Por nëse shikohet përqindja e daljes në votime (86.8%), shihet se edhe numri i qytetarëve me të drejtë vote ka qenë shumë i ulët dhe si pasojë kemi një përqindje aq të madhe të daljes në votime. Kjo mos përputhje e shifrave vie si rezultat i asaj se në vitin 2000 qytetarët serb kanë refuzuar që të pajisen me dokumente identifikuese të Kosovës dhe nuk kanë qenë të regjistruar si qytetarë me të drejtë vote. Dy vite më vonë, numri i votuesve u rrit në 7,043, apo katër herë më i madh se dy vite më parë. Por përqindja e daljes në votime është më e ulët (69.9%), pasi që kësaj radhe numri i qytetarëve me të drejtë vote ishte shtuar dukshëm. Në zgjedhjet e dyta lokale edhe qytetarët serb dolën në votime. Në 2007, serbët sërish refuzuan pjesëmarrjen, dhe numri i votuesve ishte edhe më i vogël se ai i vitit 2000. Nuk kemi mund të sigurojmë numrin e votuesve me të drejtë vote në komunën e Shtërpçës në 2007, por nëse numrin prej 1,579 votuesve e krahasojmë me 10,179 qytetarë të regjistruar për votime më 2002, atëherë pjesëmarrja në votime në 2007 ka qenë më e ulët se 15%. Në zgjedhjet e ardhshme të 15 nëntorit 2009, të drejtë vote do të kenë 12,256 qytetarë.

Tab.2. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Shtërpçë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
Votues me të drejtë vote	1837	10179	?
Pjesëmarrja në votime	1595	7043	1579
Përqindja e daljes në votime	86.8%	69.19%	?%

## Buxheti i Komunës

Si pasojë e menaxhimit të dobët dhe pamundësisë për të arkëtuar të hyra, Komuna e Shtërpçës nuk ka pasur një buxhet gjithnjë në rënie. Që nga vitit 2005 deri më 2008, buxheti gjithnjë ka shënuar rënie. Në 2009 buxheti i përgjithshëm i komunës ka shënuar ngritje dha kap shumë prej 1,643,373 euro. 56.1% e këtij buxheti shpenzohet për rroga dhe mëditje.

Tab.3. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2009	€923,314	€125,661	€32,120	€562,278	€1,643,373
2008	€730,623	€139,623	€32,120	€110,841	€1,013,207
2007	€784,051	€115,788	€47,119	€180,101	€1,127,059
2006	€924,627	€174,587	€42,500	€68,089	€1,209,803
2005	€985,662	€197,465	€59,099	€107,801	€1,355,324
2004	€1,017,693	€368,341	-	-	€1,386,034
2003	€701,946	€344,433	-	-	€1,046,379

Në vitin 2008, Komuna e Shtërpçës ka treguar shkallën më të ulët të arkëtimit të të hyrave vetanake pasi që vetëm 22.9% e mjeteve të planifikuar kanë arrit që të arkëtohen. Në pjesën e parë të vitit 2009, të hyrat vetanake janë grumbulluar më për

154% shumë se sa për të njëjtën periudhë të 2008. Por edhe më tutje të hyrat e kësaj komune janë shumë të ulëta. Për tërë vitin 2008, Komuna e Shtërpçës ka arkëtuar 45,000 euro; kurse për gjashtë mujorin e parë të 2009 janë arkëtuar 12,789 euro.

Buxheti i përgjithshëm i kësaj komunë në 2010 do të jetë 1,712,869 euro; në 2011, parashihet të jetë 1,775,283 euro; dhe në 2012 parashihet të jetë 1,840,250 euro.

## Investimet kapitale

Në vitin 2005, buxheti i destinuar për investime kapitale ka qenë 7.9% e buxhetit të përgjithshëm; në 2006, 5.6%; në 2007, 15.9%; në 2008, 10.9%. Në vitin 2009 buxheti për investime kapitale është rritur dukshëm (34.2%). Për dy vite (2008-2009), për investime kapitale kanë qenë të destinuar 1,6 milion euro. Tabela 4 paraqet disa nga projektet kapitale në dy vitet e fundit.

Tab.4.: Investimet kapitale në Shtërpçë gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës Biti e Epërme-Shushicë	59,536 €
2008	Asfaltimi i rrugës Drekoc-Firaj-Brod	15,054 €
2009	Ndërtimi i ujësjellësit në Biti të Epërme	50,000 €

Përderisa buxheti i komunës i destinuar për investime kapitale në 2008 është shpenzuar në masë të kënaqshme (94%), ai i vitit 2009 nuk është shpenzuar në masë të mjaftueshme. Në pjesën e parë të vitit, janë shpenzuar vetëm 2.4% e mjeteve. Në vitin 2010, buxheti për investime kapitale do të jetë 590,993 euro.

## Administrata komunale

Në shërbimin publik komunal janë të punësuar 319 persona (administratë, arsim dhe shëndetësi). Këtu janë llogaritur vetëm punonjësit që marrin paga nga buxheti i Kosovës. Në të tre këta sektorë ekzistojnë edhe institucionet paralele, punonjësit e të cilave paguhen nga buxheti i Serbisë. Prej 319 punonjësve, 60 janë të punësuar në administratë, 16 në shëndetësi dhe 237 në arsim. Sipas vendimit 10/46 të Qeverisë së Kosovës, Komuna e Shtërpçës nuk mund të ketë më shumë se 73 shërbyes civil. Nga kjo mund të konstatojmë se administrata komunale e Shtërpçës ka të drejtë të rrisë numrin e stafit të saj edhe për 13 punonjës.

Tab.5. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Shtimës sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	319 ▲
2008	304
2007	334
2006	395
2005	450
2004	515 ▲
2003	459 ■

Në administratën komunale të Shtërpçës janë të punësuar 60 persona, 21 shqiptarë dhe 39 serbë. Struktura gjinore është 47 meshkuj dhe 15 femra; kurse kualifikimi shkollor i tyre është 13 me shkollim superior, 5 me shkollim të lartë, 40 me shkollim të mesëm. Për shkak të mos funksionimit të Kuvendit Komunal dhe mos punës së kryetarit të komunës, as shërbimi civil nuk është në nivel të detyrës. Mirëpo të gjithë bashkëbiseduesit kanë fjalë të mira për punën e shërbimit civil. Kjo vetëkënaqësi për punën e administratës komunale të Shtërpçës vjen si rezultat i asaj se në krahasim me funksionet e strukturave politike të komunës, shërbimi civil është më në nivel të detyrës. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, të gjithë shërbyesit civil nga komuniteti serb kishin bojkotuar punën, mirëpo me zgjedhjen e nënkryetarit të komunës, ishin shpallur pozitivat me konkurs dhe janë pranuar serb të rinj që tani janë më të përgjegjshëm në punë.

Në ndërtesën e Kuvendit Komunal të Shtërpçës janë të vendosura edhe strukturat paralele të cilat janë të jashtë ligjshme dhe mbajnë tetë zyre në këtë ndërtesë duke bërë që ti ngushtohet hapësira punuese shërbyesve civil të komunës legjitime të Shtërpçës. Strukturat paralele gjithnjë kanë bërë përpjekje që të uzurpojnë edhe zyre tjera në ndërtesën e komunës, siç është rasti me zyrën e kadastrit e cila është uzurpuar nga strukturat paralele, mirëpo është kthyer sërish në menaxhim të komunës. Po në këtë ndërtesë, UNMIK-u mban ende dy zyre të punës, policia e UNMIK-ut ka një zyre, një zyre OSBE dhe dy zyre KFOR-i.

## **Komuna e Shtërpçës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale**

Për arsye politike dhe mospjesëmarrjes së serbëve në jetën publike komunale, Komuna e Shtërpçës gjatë këtyre dy viteve nuk ka respektuar dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale. Me këtë ligj kërkohet që Kuvendet Komunale të mbajnë së paku 10 mbledhje të rregullta në vit, 5 prej tyre në pjesën e parë të vitit. KK i Shtërpçës ka mbajtur vetëm 2 mbledhje gjatë tërë vitit 2008 dhe 2 në periudhën janar-qershor 2009. Komisionet legjislative nuk kanë funksionuar fare gjatë këtyre viteve, si dhe Kryetari i Komunës nuk ka mbajtur asnjëherë tubime publike me qytetarë, ashtu siç kërkohen me ligj (së paku dy tubime në vit).

Komuna e Shtërpçës është një nga gjashtë komunat e Kosovës që nuk ka uebfaqe zyrtare.

## **Gjendja në arsim**

Në Komunën e Shtërpçës arsimi zhvillohet në tri nivele: parafillor, fillor dhe të mesëm. 15 objekte shkollore janë të ndara në dy sisteme arsimore: atë të Kosovës dhe shkollat serbe të cilat zhvillojnë mësim sipas planprogrameve të Ministrisë së Arsimit të Serbisë.

Shkollat nën sistemin arsimor të Kosovës janë 8 filllore dhe një shkollë e mesme. Në këtë komunë nuk funksionon asnjë çerdhe. Në këto tetë shkolla funksionojnë 55 paralele. Numri i nxënësve për çdo paralele është i ulët, ku mesatarja e nxënësve për paralele është 12.51.

## Gjendja në shëndetësi

Qendra e Shëndetit në Shtërpcë menaxhohet nga strukturat paralele serbe. Qytetarët shqiptarë zakonisht për raste më të rënda shëndetësore drejtohen në spitalin regional të Ferizajt. Ambulanca që ndodhet në Drajkovc është multietnike ndërsa ambulanca në fshatin Brod është udhëhiqet nga stafi kryesisht shqiptar. Qytetarët ankohen për mungesë të rregullit në ambulanta, mungesë të kujdestarisë së mjekëve dhe mungesë të barnave nga lista esenciale.

## Shoqëria civile

Në komunë e Shtërpcës veprojnë disa organizata jo qeveritare mjaft aktive. OJQ "Sharri" është aktive në organizimin e debateve, mobilizim të qytetarëve në shkrimin e peticioneve dhe formulimin e kërkesave ndaj institucioneve qeveritare, mbrojtje të ambientit, etj. Organizata tjera aktive janë edhe OJQ "Paqja", OJQ "Fieri", "Tradita", etj.

## Mediat lokale

Ekziston një medium lokal TV Herc. Ngritja e këtij mediumi është bërë me ndihmën financiare të donatorëve dhe ishte paraparë që të shërbej si medium që transmeton program në dy gjuhë: shqipe dhe serbe. Mirëpo, ky televizion ka transmetuar program dy gjuhësor vetëm disa muaj dhe tani i tërë programi është në gjuhën serbe. TV Herc në listat e medimeve të licencuara nga Komisioni i Pavarur i Mediave figuron si medium multietnik.

Qytetarët e kësaj komunë nuk kanë qasje në sinjalin tokësor të RTK, edhe pse paguajnë 3.5 euro në muaj. Qytetarët janë të frustruar me faktin se detyrohen të paguajnë për një shërbim që nuk e marrin. Këtë pakënaqësi e kanë shprehur edhe me protesta dhe bllokim të rrugëve. Për këtë komunë raportojnë gazetarët e "Zëri"-it dhe "Koha Ditore". Por gazetaret ditore gjenden të pakta në numër dhe shiten vetëm në një pikë. Televizionet nga Serbia kanë sinjal të gjerë në këtë komunë.

## Rendi dhe ligji në Komunën e Shtërpcës

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Shtërpcës kanë ndodhur 200 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 33 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.6. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Shtërpcë (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	10
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	21
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	5
Vjedhje e pyjeve	1

Incidente lidhur me pronën	7
Vjedhje	34
Abuzime seksuale	3
Shkaktim të dëmtimeve trupore	2
Kërcënime	12
Mashtrome	2
Vrasje	0
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	0

## Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimoretë mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05% dhe 1% të vlerës së pronës në treg. Tarifatatimoretë lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj, Kuvendi Komunal i Shtërpcës ka miratuar Rregulloren komunale për tatim në pronë me të cilën ka caktuar zonat e komunës, normën tatimore dhe çmimin e pronës në treg.

Tab.7. Tatimi në pronë në Komunën e Shtërpcës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
<b>Norma tatimore</b>					
	0.08%	0.08%	0.15%	0.12%	0.10%
Zona	<b>Vlera e tregut për metër katror</b>				
I	440 €		480 €	450 €	440 €
II	300 €		380 €	350 €	300 €
III	180 €		350 €	320 €	180 €
IV	150 €		310 €	280 €	150 €
V	110 €		270 €	240 €	110 €

## Kostoja për biznese

Duke u bazuar në Rregulloren komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, më poshtë kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe shumatat e mjeteve që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.8. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	400 €
Kompanitë e sigurimit	250 €
Pompat e benzinës (derivatet e	400 €

naftës)	
Kompanitë ndërtimore	100-150 €
Kafenetë	150 €
Hotelet	200 €
Motelet	200 €
Restorantet	150 €
Supermarketet-Hipermarketet	200 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	100 €
Agjensionet turistike	50 €
Barnatoret farmaceutike	150 €
Auto-mekanikët	-
Gurëthyesit	-
Depo të materialit ndërtimor	200 €
Auto-shkollat	100 €

## Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
7. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
8. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
9. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
11. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
12. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
13. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
14. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
15. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.